



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK

AMENDAMENT NR. _____

I

RREGULLORES SË BRENDSHME

TË

DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK

Bazuar në nenin 23, pika 9 të Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, i ndryshuar, VKM Nr. 840, datë 17.12.2004 “Për Veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik” i ndryshuar, pikën 2 të kreut II të VKM nr. 568, datë 06.10.2021, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Këshilli Drejtues vendosi ndryshimin e pikës 1 të nenit 48 të rregullores së brendshme të DSHTD-së, si dhe shtimin e pikave 1/1 dhe 1/2, në po këtë nen si më poshtë:

- 1. Kohëzgjatja ditore e orëve të punës për punonjësit e DSHTD, nga e hëna në të enjte, është 8 orë e 30 minuta, ndërsa ditën e premte është 6 orë.**
- 1/1. Orari i punës për punonjësit e DSHTD-së do të jetë me dy fasha orare, të cilët mund të zgjedhin një prej varianteve si më poshtë:**
 - a. 08 : 00 – 16 : 30 nga e hëna në të enjte, si dhe 08 : 00 – 14 : 00 ditën e premte;**
 - b. 07 : 30 – 16 : 00 nga e hëna në të enjte, si dhe 07 : 30 – 13 : 30 ditën e premte;**
- 1/2. Në raste të veçanta, me kërkesë të arsyetuar dhe me miratim nga Drejtori i DSHTD-së, punonjësit mund të kryejnë orët e plota ditore të punës sipas pikës 1 të këtij neni, në një fashë tjetër orare, por me kushtin që detyrimisht duhet të jenë në punë nga e hëna në të enjte, 9:30 –15:30, ndërsa ditën e premte 9:30 – 13:00.**